



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVO

RREGULLORE

për sistemin e vetëm të transferimit të kredive dhe kalimin nga një program studimi në tjetrin, gjegjësisht nga një njësi në tjetrën të Universitetit, respektivisht nga një universitet në universitetin tjetër

Tetovë, 2022

Në bazë të nenit 94 pika 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018) dhe nenit 85 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022 solli këtë

RREGULLORE

për sistemin e vetëm të transferimit të kredive dhe kalimin nga një program studimi në tjetrin, gjegjësisht nga një njësi në tjetrën të Universitetit, respektivisht nga një universitet në universitetin tjetër

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen bazat unike për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit dhe sistemit të studimit sipas sistemit të vetëm transferimit të kredive (në tekstin e mëtejme: ECTS), kalimin nga një program studimi në tjetrin, kalimin nga një njësi në tjetrën brenda Universitetit, kalimin nga një universitet në një universitet tjetër brenda dhe jashtë vendit, si dhe transferimin dhe njohjen e ECTS kredive të fituara në një njësi tjetër të Universitetit, gjegjësisht në një institucion të arsimit të lartë.

Neni 2

"Sistemi i kredive" është sistem për grumbullimin dhe transferimin e kredive bazuar në transparencën e rezultateve të të nxënit dhe proceseve të mësimin në arsimin e lartë.

"Sistemi i transferimit të kredive" është një procedurë e përbashkët që krijohet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive - ECTS ose Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (anglisht: European Credit Transfer and Accumulation System) dhe është një sistem numerik për vlerësimin cilësor të punës së studentëve që është investuar për përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të parapara nga programi i studimit, gjegjësisht me lëndën specifike në kuadër të atij programi, përfshin pikët për përvetësimin e lëndës në tërësi, të gjitha lëndët në një semestër, vitin akademik dhe studimin në tërësi si dhe transferimin e tyre nga një institucion i arsimit të lartë në tjetrin.

"Kreditë" paraqesin masë sasiore për të shprehur vëllimin e të mësuarit bazuar në vëllimin e punës që studenti e kryen mesatarisht, gjegjësisht ngarkesën e studentit, e cila përfshin ligjërata, seminare, ushtrime, forma të tjera të punës së organizuar studimore dhe mësimin e

pavarur, të cilat synojnë arritjen e rezultateve të pritura të procesit mësimor. Kreditë i jepen studentit dhe regjistrohen në dosjen e tij kur ai përmbush detyrimet studimore;

Neni 3

Me sistemin e transferit të kredive arrihet:

- rritja e lëvizshmërisë së studentit në nivel institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- pasqyrë e saktë në vëllimin e punës dhe shprehje e ngarkesës së studentit në procesin e studimit;
- zhvillimi dhe funksionimi i mekanizmave për monitorimin e përhershëm të përparimit të studentit sipas rezultateve të mësimit;
- objektivitet në vlerësim dhe njohjen e rezultateve të studimit;
- realizimi i përputhshmërisë së programeve të studimit në nivel institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- vendosja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe arritja e përputhshmërisë së programeve të studimit në nivel ndërkombëtar, sipas parimeve të Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive - ECTS ose Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Pikëve (Anglisht: European Credit Transfer and Accumulation System);
- transferimi i pandërprerë i arritjeve të studentit nga një institucion në tjetrin;
- rritja e individualizimit gjatë studimit dhe
- krijimi i bazave për realizimin e konceptit për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Zbatimi i sistemit të transferimit të kredive

Neni 4

Sistemi i transferimit të kredive zbatohet në realizimin e programeve të studimit dhe lëndëve për:

- studimet akademike të ciklit të parë (studimet universitare);
- studimet akademike të ciklit të dytë (studimet pasuniversitare);
- studimet e integruara akademike nga cikli i parë dhe i dytë;
- studimet akademike të ciklit të tretë (studimet e doktoratës);
- studimet profesionale të ciklit të parë;
- studimet profesionale të ciklit të dytë;
- studimet e specializuara të ciklit të tretë.

Neni 5

Programet e studimit vlerësohen me ECTS kredi. Çdo vit i programit të studimit përmban 60 kredi.

Çdo lëndë e programit të studimit vlerësohet me një numër të caktuar të ECTS kredive.

Programet e studimit në të gjitha vitet e studimit të studimeve universitare, pasuniversitare dhe të doktoratës duhet të përmbajnë lëndë të detyrueshme dhe fakultative (zgjedhore), me përjashtim të programeve të studimit për profesionet e rregulluara të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, programeve të studimit për studimet e drejtësisë dhe programeve të studimit për aftësimin bazë të mësimdhënësve në arsimin në fillor dhe atë të mesëm.

Lëndët e detyrueshme në programin e studimit duhet të jenë nga fusha përkatëse e njësisë së Universitetit, pra e njësisë së brendshme organizative (instituti, katedra, departamenti).

Studentët i zgjedhin lëndët zgjedhore nga lista e lëndëve zgjedhore të programit të caktuar të studimit.

Lëndët zgjedhore përbëjnë të paktën 10% dhe më së shumti 30% të numrit të ECTS kredive në programin e studimit.

Shuma e ECTS kredive të lëndëve të përfaqësuara në listën e lëndëve zgjedhore të programit të studimit është të paktën dyfishi i numrit të ECTS kredive të parashikuara në planprogramin për lëndët zgjedhore.

Secila nga lëndët në listën e lëndëve zgjedhore duhet të ketë numër të barabartë të ECTS kredive.

Në listën e lëndëve zgjedhore të programit të lëndës që realizohet në njësinë e Universitetit mund të përfshihen edhe lëndë që realizohen në një njësi tjetër të Universitetit.

Programet e studimit të njësive të Universitetit, në seksionin e lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore, mund të përmbajnë edhe “dritare për lëvizshmëri”, pra lëndë, aktivitetet e të cilave mund të realizohen edhe në gjuhën angleze.

Kur Universiteti realizon një program studimi për marrjen e diplomës së përbashkët me një universitet të huaj, në raportin e përfaqësimit të lëndëve të detyrueshme dhe atyre zgjedhore zbatohet rregullorja e Universitetit, në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Përmbajtja e programeve të studimit rregullohet më hollësisht me Ligjin për Arsimin e Lartë, Rregulloren për përmbajtjen e programeve të studimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i

Arsimit të Lartë, rregulloret për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe të studimit në studimet universitare të ciklit të parë të dytë dhe të tretë si dhe Elaboratin e programit studimor.

Mënyra e dhënies së kredive

Neni 6

Numri i kredive për lëndët përcaktohet në bazë të ligjëratave, ushtrimeve, seminareve, mësimdhënies individuale dhe formave të tjera të studimeve që i përshtaten specifikës së fushës mësimore-shkencore dhe artistike (përgatitje praktike, shtrimi në spital, shfaqje, puna në terren etj.), mësimdhënie konsultative - udhëzuese, format e verifikimit të vazhdueshëm të njohurive dhe provimeve që konsiderohen si orë kontakti, si dhe punë individuale studimore (punë sportive, kërkime letrare, detyra seminarike, punë projektuese), studim i pavarur, si dhe përgatitja e tezës së diplomës (masterit, doktoraturës).

Kreditë mund të jepen edhe për lloje të ndryshme aktiviteteve studentore: praktikë profesionale, përpunimin ose realizimin e projektit, pjesëmarrje në një takim profesional, pjesëmarrje në shkollë dimërore ose verore etj.

Aktivitetet për të cilat do të jepen kredi përcaktohen nga njësia e Universitetit.

Këto kredi futen në shtojcën e diplomës në rubrikën e informacionit shtesë për aktivitetet e realizuara.

Neni 7

Gjatë përcaktimit të numrit të ECTS kredive për një lëndë të caktuar, duhet të merren parasysh:

1. Një vit akademik përmban 60 ECTS kredi, ndërsa një semestër 30 ECTS kredi;
2. Studenti gjatë studimeve është i angazhuar (merr pjesë në mësimdhënie dhe konsultime, përgatitet për mësim, studion, përgatit detyra projektuese, projekte etj.) 5 ditë në javë, pra gjithsej 40 orë në javë.

Neni 8

Të gjitha lëndët e detyrueshme për një program të caktuar studimi bartin një numër të caktuar ECTS kredish që inkuadrohen në ngarkesën maksimale të studentit. Këshillat mësimorë-shkencorë të njësive të Universitetit marrin vendim për numrin, shpërndarjen dhe harmonizimin e ECTS kredive për lëndët obligative.

Lëndët e detyrueshme janë baza e njohjes së një programi studimi, sipas të cilit ato janë të përafëruara me programe studimi të njëjta ose të ngjashme në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Të gjitha lëndët zgjedhore për një program të caktuar studimi bartin një numër të barabartë ECTS kredish që përshtaten me ngarkesën maksimale të punës së studentit.

Këshillat mësimorë-shkencorë të njësive të Universitetit marrin vendim për numrin, shpërndarjen dhe harmonizimin e ECTS kredive për lëndët zgjedhore.

Lëndët zgjedhore sigurohen në nivel të të njëjtit program studimi, në nivel të së njëjtës njësi të Universitetit dhe nga një njësi tjetër e Universitetit.

Universiteti mund të inkuadrojë edhe të ashtuquajturat lëndë jashtëshkollore, zgjedhore ose të detyrueshme (si aktivitetet fizike - sportive, gjuha e dytë, etj.), me ngarkesë totale në një semestër në përputhje me programin lëndor të propozuar, por jo më shumë se 4 ECTS kredi.

Përpunimi i tezës së diplomës/provimit përfundimtar vlerësohet me më shumë ECTS kredi.

Përpunimi i tezës së doktoratës/masterit/specializimit vlerësohet me maksimum 30 ECTS kredi.

Neni 9

ECTS kreditë jepen vetëm për ata studentë që plotësojnë kushtet për ta dhënë provimin dhe e përfundojnë me sukses lëndën përkatëse. Kushtet që duhet të plotësojë studenti për të përfunduar me sukses programin e lëndës, përcaktohen nga njësia e Universitetit.

VËLLIMI I STUDIMEVE DHE KONTROLLI I NJOHURIVE

Neni 10

Brenda një maksimumi prej 40 javësh në vit, ngarkesa totale e studentëve shkon në 1500 deri në 1800 orë në vit.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë së paku 20 e më së shumti 30 orë ligjërata, ushtrime dhe seminare në javë dhe 30 javë në vit.

Me përjashtim, nëse programi i studimit përmban trajnim praktik, ngarkesa totale e studentit nuk duhet të kalojë 40 orë në javë dhe 45 javë në vit.

Ngarkesa e studentëve përfshin ligjërata, ushtrime, seminare, mësimdhënie individuale dhe forma të tjera studimi që i përshtaten specifikës së fushës mësimorë-shkencore dhe artistike (trajnime praktike, praktika, performanca, punë në terren, etj.), mësimdhënie konsultative-instruktive, format e kontrollit të vazhdueshëm të njohurive dhe provimet që konsiderohen si orë kontakti, si dhe punë individuale studimore (punë sportive, kërkime letrare, detyra seminarike, punë projektuese), studim i pavarur, si dhe përgatitja e tezës së diplomës (masterit, doktoraturës).

Angazhimi i studentit gjatë semestrit është 20 javë. Ligjëratat, ushtrimet, seminarët dhe format e tjera të studimeve që janë të përshtatshme për specifikat e fushës mësimore-shkencore zhvillohen brenda semestrave - në kohëzgjatje prej 12 javësh. Për përgatitje për vlerësim janë planifikuar 8 javë. Aktivitetet në kuadër të një semestri kanë orarin e mëposhtëm:

- 6 javë ligjëratat dhe mësim,
- 1 javë për realizimin e kolokiumit të parë,
- 6 javë ligjëratat dhe mësim,
- 1 javë për realizimin e kolokiumit të dytë,
- javë për vlerësimin përfundimtar në kuadër të afateve të provimit.

Neni 11

Në semestrin dimëror dhe atë veror, kolokiumi i parë realizohet në javën e shtatë.

Në semestrin dimëror dhe atë veror, kolokiumi i dytë realizohet në javën e katërmëdhjetë.

Vlerësimi përfundimtar bëhet brenda afateve të provimit të përcaktuara nga Këshilli i Rektoratit i Universitetit.

Vlerësimi i vazhdueshëm, si dhe vlerësimi përfundimtar dhe rezultatet e arritura të studentëve, publikohen në përputhje me aktet për studimet në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë.

Neni 12

Gjatë përgatitjes së programeve të studimit dhe lëndëve, njësitë e Universitetit duhet të mundësojnë përputhshmërinë e tyre institucionale dhe kombëtare dhe të krijojnë kushte për kalimin e studentit nga një program studimi në tjetrin brenda një njësie, kushte për kalimin nga një njësi në tjetrën brenda Universitetit, si dhe kushtet për transferim nga një njësi jashtë Universitetit, në rastet kur ka njësi që trajnojnë të njëjtin apo profil të ngjashëm të kuadrit akademik dhe profesional, si dhe për transferimin e studentit nga një njësi në tjetrën, pra në një njësi universitare në shtet dhe jashtë vendit.

Përputhshmëria nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni nuk paraqet njejtësim, por harmonizim të programeve të studimit dhe lëndëve ndërmjet dy institucioneve që formojnë profile të njëjta ose të ngjashme.

KRIJIMI I PËRPUTSHMËRISË INSTITUCIONALE DHE KOMBËTARE TË PROGRAMEVE STUDIMORE

Neni 13

Njësitë e Universitetit gjatë përgatitjes së programeve të studimit dhe lëndëve duhet të mundësojnë përputhshmërinë e tyre institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare, përkatësisht krahasueshmërinë dhe njohjen në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, si dhe krijimin e kushteve për kalimin e studentit nga një program studimi në tjetrin brenda njësisë së Universitetit, gjegjësisht institutit shkencor, si dhe kushtet për transferim nga një njësi e Universitetit, gjegjësisht institut shkencor brenda Universitetit, kushtet për transferim në një njësi tjetër të universitetit, gjegjësisht institut shkencor, jashtë universitetit, në rastet kur ka njësi, të cilat prodhojnë profil të njëjtë ose të ngjashëm të kuadrit profesional, si dhe kushte për kalimin e studentit në universitete jashtë vendit.

Neni 14

ECTS kreditë ndahen vetëm për studentët që do të kryejnë me sukses të gjitha aktivitetet e parashikuara nga programi në fjalë. Nuk mund të ketë ndarje të pjesshme të kredive.

PËRPARIMI I STUDENTIT PËRMES PROGRAMEVE STUDIMORE

Neni 15

- (1) Studenti e fiton të drejtën e regjistrimit në semestrin e ardhshëm të studimeve kur i përmbush të gjitha obligimet studimore të shprehura në ECTS kredi, të parapara me regjistrimin në semestrin paraprak.
- (2) Studenti mund të regjistrojë vetëm ato lëndë për të cilat ka fituar të drejtën sipas programit të studimit dhe planit të studimit.
- (3) Programi dhe plani i studimeve mund të bazohet në regjistrimin e semestrave, përkatësisht të vitit studimor.
- (4) Studenti që nuk i plotëson kushtet për regjistrim në një vit të lartë të parashikuar në paragrafin 2, mund të vazhdojë studimet në atë mënyrë që të reregjistrojë detyrimet e studimit që nuk i ka përmbushur në semestrin e kaluar dhe të regjistrojë lëndë të reja, por në mënyrë të tillë që detyrimet totale të studimit në një semestër të mos kalojnë 21-35 ECTS kredi, përveç nëse me akt të përgjithshëm të Universitetit rregullohet ndryshe.

(5) Me programin dhe me planin e studimit në të cilin mësimi zhvillohet në mënyrë semestrale, mund të parashikohen përjashtime nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, për t'i dhënë mundësi studentit të regjistrohet në vitin/semestrin vijues në kushtet kur nuk ka përmbushur vetëm një pjesë të detyrimeve të tij në vitin/semestrin paraardhës.

(6) Studenti përparon gjatë studimeve, pra regjistron lëndë sipas numrit të kredive të fituara.

Neni 16

Studenti në ciklin e parë të studimeve mund të regjistrojë minimalisht 21 kredi, por jo më shumë se 40 kredi për semestër.

Studenti mund të regjistrojë një numër më të vogël kredish se ato të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm nëse ka lëndë të mbetura që mbajnë një numër total kredish më pak se 21.

Neni 17

Studenti në ciklin e dytë të studimeve mund të regjistrojë minimalisht 21 kredi, por jo më shumë se 40 kredi për semestër.

Studenti mund të regjistrojë një numër më të vogël kredish se ato të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm nëse ka lëndë të mbetura që mbajnë një numër total kredish më pak se 21.

Neni 18

Studenti në ciklin e tretë të studimeve mund të regjistrojë edhe një numër më të vogël ose më të madh kredish për semestër, por jo më pak se 15 dhe jo më shumë se 50 kredi për semestër, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për regjistrimin e tezës së doktoraturës.

Studenti mund të regjistrojë një numër më të vogël kredish se ato të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm nëse ka lëndë të mbetura që kanë një numër total kredish më të vogël se 15.

Nëse student i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tjera sipas programit të studimit, por nuk ka doktoruar, ai mund të regjistrojë kreditë nga teza e doktoraturës si në semestrin dimëror ashtu edhe në atë veror.

Neni 19

Koha kur student mund të kalojë nga një program studimi në tjetrin brenda njësisë së Universitetit nuk mund të jetë më herët se para regjistrimit të lëndëve të semestrit të tretë.

Duke filluar nga semestri i tretë, studentët mund të regjistrohen njëkohësisht në lëndë të një programi tjetër studimi për ta përvetësuar atë, me ç'rast numri i përgjithshëm i kredive nga të dy programet e studimit nuk e kalon numrin 42 për ciklin e parë dhe të dytë, gjegjësisht 50 për ciklin e tretë të studimeve në një semestër. Pas përfundimit me sukses të të dy programeve të studimit, student merr dy diploma.

Studentët që studiojnë paralelisht nuk mund të kenë statusin e studentit të rregullt në të dy programet e studimit.

Neni 20

Studenti ka të drejtë që gjatë studimeve të regjistrohet në lëndë që nuk janë të detyrueshme për marrjen e shkallës së caktuar të përgatitjes profesionale me programin e studimit në të cilin është regjistruar studenti, duke respektuar dispozitën për numrin minimal dhe maksimal të kredive që mund të regjistrohen.

Neni 21

(1) Studenti mund të regjistrojë lëndë të reja nga semestri i ardhshëm, në përputhje me rregullat për avancim të përcaktuara në programin përkatës të studimit.

(2) Njësia, në kuadër të programit të studimit, mund të përcaktojë kriteret e kushtëzimit, d.m.th. lëndët e zotëruara më parë (kreditë e fituara, lëndët e kaluara dhe/ose të dëgjua etj.), si kusht për regjistrimin e lëndëve të tjera.

(3) Regjistrimi i lëndëve në semestrin vijues bëhet para fillimit të semestrit përkatës.

Neni 22

(1) Gjatë regjistrimit të lëndëve studenti fillimisht i regjistron lëndët obligative dhe zgjedhore të pakaluara nga semestri përkatës (veror/dimër), pastaj lëndët obligative nga semestri aktual dhe në fund lëndët zgjedhore nga semestri aktual, por në mënyrë që obligimet totale të studimit në një semestër të mos i kalojnë 35 ECTS kredi, ndërsa për studentët që regjistrohen në semestrin e fundit veror apo dimëror të mos kalojnë 40 ECTS.

(2) Në semestrin dimëror regjistrohen lëndët që përcaktohen në programet e studimit për semestrin dimëror.

(3) Në semestrin veror regjistrohen lëndët që përcaktohen në programet e studimit për semestrin veror.

(4) Monitorimi, drejtimi dhe mbështetja administrative e studentit gjatë studimeve rregullohen me Statutin e njësisë në kuadër të Universitetit.

(5) Gjatë regjistrimit të lëndëve, është e nevojshme të plotësohen kushtet e përcaktuara me programet e studimit.

(6) Gjatë reregjistrimit të lëndës zgjedhore të pakaluar, studenti ka të drejtë ta ndërrojë lëndën zgjedhore me lëndë tjetër zgjedhore nga lëndët që janë aktive në semestrin përkatës si lëndë zgjedhore.

Neni 23

Studentët që i reregistrojnë lëndët mund të regjistrojnë një lëndë të re, e cila sipas programit të studimit kërkon kalimin paraprak të lëndës që reregjistrohet, por kalimi i lëndëve duhet të jetë i njëpasnjëshëm.

Neni 24

Evidenca e lëndëve që regjistrohen, të dhënat nëse janë lëndë të reregjistruara apo lëndë të reja, si dhe shuma e tarifës së shkollimit (pagesës së semestrit) bëhen nëpërmjet formularëve të aplikimit (fletëparaqitjeve).

Forma dhe përmbajtja e formularit të aplikimit (fletëparaqitjes) përcaktohet nga prorektori për arsim.

Korrektësia e të dhënave në formularin e aplikimit (fletëparaqitje) konfirmohet me nënshkrimin e koordinatorit dhe/ose administratorit për ECTS për programin përkatës të studimit dhe verifikohet nga dekani.

Neni 25

Pagesa e tarifës për participim dhe tarifa e shkollimit gjatë regjistrimit të semestrit përcaktohet sipas kredive të regjistruara në përputhje me masat dhe kriteret për shumën e tarifave që paguajnë studentët për shërbime arsimore dhe administrative.

Neni 26

Dispozitat e këtij kreu që i referohen mënyrës së dhënies së kredive dhe avancimit nëpër programet e studimit do të zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në programet e studimit në studimet e ciklit të dytë dhe të tretë.

Dispozitat më të afërta për aktivitetet nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohen me vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor/Shkencor të Njesisë.

Studimet me korrespondencë

Neni 27

Për studentët me korrespondencë mund të parashikohen aktivitete shtesë, në pikëpamje të organizimit të mësimi të kondensuar dhe përgatitjes së punimeve seminarike shtesë, punë praktike, detyra shtëpie etj., si kompensim për orët e mësimi dhe ushtrimet nga semestrat aktualë.

Për studentët me korrespondencë dhe ata të rregullt, të cilët kanë reregjistruar lëndë mund të organizohet mësim i kondensuar.

Vendimi për organizimin e mësimit të kondensuar merret nga këshilli mësimesh-shkencor/mësimesh/shkencor i njësisë.

Zbatimi i sistemit për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të suksesit të studentëve

Neni 28

Gjatë studimeve, studenti e arrin numrin e kërkuar të kredive për programin përkatës nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm ose përfundimtar të të gjitha aktiviteteve të parashikuara në programin e lëndës.

Gjatë formimit të notës përfundimtare, shpërndarja e pikëve bëhet në përputhje me elaboratin e akreditimit të programit përkatës të studimit.

Numri i përgjithshëm i pikëve është 100.

Kolokiumi, gjegjësisht vlerësimi përfundimtar konsiderohet pozitiv, nëse studenti shënon të paktën 51 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve të parashikuara për kolokiumin, gjegjësisht për vlerësimin përfundimtar nga dy kolokiumet ose provimi.

Provimi konsiderohet i kaluar nëse studenti shënon gjithsej të paktën 51 pikë nga pikët që dalin nga kolokiumet, gjegjësisht nga provimi përfundimtar dhe/ose pikët nga aktivitetet tjera.

Neni 29

Aktivitetet tjera në kuadër të programit të lëndës përfshijnë:

- pjesëmarrja në ligjërata dhe aktiviteti në ligjërata;
- konsultimet e kryera;
- ushtrime të kryera me sukses (duke përfshirë pjesëmarrjen dhe aktivitetin);
- punë praktike të kryer me sukses;
- përgatitja e punimit seminarik;
- punë e pavarur (në shtëpi);
- të mësuarit në bibliotekë;
- mentorimi i studentëve të tjerë;
- projekte të krijuara ose të realizuara;
- marrja e çmimeve ose lëvdate;
- pjesëmarrja në seminare;
- pjesëmarrja në simpoziume dhe
- aktivitete të tjera të parashikuara nga programi i lëndës.

Mësimdhënësi i lëndës nuk duhet t'i angazhojë studentët jashtë aktiviteteve të planifikuara. Dispozitat më të afërta për llojin dhe mënyrën e vlerësimit të aktiviteteve të veçanta për të gjitha disiplinat mësimore përcaktohen me akt të njësisë, në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 30

Studentët mund të fitojnë kredi nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të planifikuara për një lëndë të caktuar për të cilën jepen një numër i caktuar pikësh.

Pas dhënies me sukses të provimit përfundimtar, studentët i fitojnë kreditë e përcaktuara për lëndën përkatëse dhe në varësi të pikëve të fituara marrin notën e duhur për lëndën.

Neni 31

Studentët e rregullt janë të detyruar t'i ndjekin rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet.

Studenti i rregullt mund të mungojë në ligjëratat ose ushtrime deri në tre herë gjatë semestrit, në të kundërt nuk ka të drejtë të hyjë në kolokiume.

Nëse studenti nuk i kalon kolokiumet si mënyrë e dhënies së provimit, atëherë ai e kalon të gjithë materialin e paraparë në programin e lëndës në provimin përfundimtar.

Neni 32

Në kuadër të vlerësimit të vazhdueshëm studenti mund të hyjë në dy kolokiume.

Studenti ka të drejtë të hyjë në kolokiumin e dytë nëse e ka kaluar kolokiumin e parë.

Nëse studenti nuk i kalon kolokiumet, ai e jep provimin përfundimtar në afatet vijuese të provimeve.

Neni 33

Për vlerësimin e vazhdueshëm, si edhe për vlerësimin përfundimtar, rezultatet e arritura të studentëve publikohen në tabelën e shpalljeve, në faqen e internetit të njësisë, në sistemin elektronik etj., më së voni brenda 7 ditëve nga mbajtja e kolokiumit, gjegjësisht provimit. Rezultatet e publikuara përmbajnë përshkrim të plotë të mënyrës së formimit të notës përfundimtare.

Neni 34

- (1) Kontrolli i njohurive të studentit për lëndët mësimore kryhet vazhdimisht gjatë procesit mësimor-edukativ dhe shprehet në pikë.
- (2) Për përmbushjen e detyrimeve për dhënien e provimit (në pjesë ose në tërësi) studenti merr notë të shprehur në numra nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë), me ç'rast nota 5 (pesë) tregon sukses të pamjaftueshëm.

- (3) Provimi për një lëndë mësimore mund të jepet më së shumti tri herë, nga të cilat herën e katërt, me kërkesë të studentit, provimi mbahet para komisionit të përbërë nga tre anëtarë që janë mësimdhënës të fushës mësimore të njëjtë ose të ngjashme. Komisioni themelohet nga dekani.
- (4) Në komisionin nga paragrafi paraprak i këtij neni nuk është anëtar mësimdhënësi te i cili studenti ka hyrë në provim.
- (5) Studenti i cili ka dështuar në provim për herë të katërt është i detyruar ta regjistrojë atë lëndë në vitin e ardhshëm akademik.
- (6) Kontrolli i njohurive në lëndët e caktuara mësimore bëhet në mënyrën e përcaktuar nga mësimdhënësi i lëndës, i cili përfshihet edhe në programin e studimit dhe kryhet brenda afateve të përcaktuara me këtë Rregullore.
- (7) Vlerësimi përfundimtar duhet të shënohet në indeks, raportin e provimeve të mbajtura dhe në fletëparaqitjen për vlerësim përfundimtar.
- (8) Suksesi mesatar i studentit është mesatarja aritmetike e notave nga vlerësimi përfundimtar për të gjitha lëndët mësimore gjatë studimeve, duke përfshirë edhe provimin përfundimtar nëse provimi është i paraparë në programin e studimit.

Neni 35

Studenti mund t'i lërë studimet në kuadër të një programi të caktuar të studimit pa e përfunduar atë, dhe për këtë mund të marrë certifikatë për provimet e dhëna dhe aktivitetet e realizuara.

Në certifikatë regjistrohen lëndët mësimore, aktivitetet e realizuara, notat dhe numri i kredive të fituara nga studenti gjatë studimeve.

Neni 36

Për zbatimin dhe monitorimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, njësia e Universitetit mund të caktojë një koordinator dhe/ose administrator për ECTS në nivel njësie, përkatësisht në nivel të njësisë së brendshme organizative që rregullohet me akt të përgjithshëm të njësisë.

Me aktin e përgjithshëm të njësisë caktohen edhe kompetencat, obligimet dhe detyrat e personave nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Universitet, me këtë rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme të Universitetit.

LËVIZJA E STUDENTIT BRENDË UNIVERSITETIT

Neni 37

Studenti mund të transferohet nga një program studimi në tjetrin brenda së njëjtës njësi, si dhe në një program studimi të një njësie tjetër, në përputhje me procedurat e transferimit nga një program studimi në tjetrin brenda së njëjtës njësi, pra për transferim nga një njësi në një tjetër në kuadër të Universitetit të Tetovës.

Kriteret e transferimit përcaktohen nga njësia në varësi të përputhshmërisë së programeve të studimit.

Neni 38

Gjatë transferit nga një njësi në tjetrën, studenti lirohet nga dhënia e provimit, gjegjësisht nga ndjekja e mësimëve në lëndë/provime të caktuara, nëse njësitë ndërmjet të cilave bëhet transferimi kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjellë ose me lejen e njësisë në të cilën transferimi bëhet në bazë të njohjes së mëparshme të përmbajtjes dhe numrit të ECTS kredive për lëndët/provimet përkatëse që studenti i ka marrë në kuadër të njësisë nga e cila vjen.

Neni 39

Gjatë studimeve, studenti ka të drejtë të regjistrojë lëndë të reja mësimore të njësisë që nuk janë të detyrueshme për marrjen e një shkalle të caktuar përgatitjeje profesionale, si dhe të regjistrojë lëndë të reja mësimore të një njësie tjetër, duke respektuar dispozitën për numrin maksimal të ECTS kredive që mund të regjistrohen.

LËVIZSHMËRIA MIDIS UNIVERSITETEVE DHE INSTITUCIONEVE TJERA TË ARSIMIT TË LARTË NË VEND DHE JASHTË TIJ

Neni 40

Studenti mund të transferohet nga një njësi në tjetrën brenda Universitetit të Tetovës dhe/ose nga një universitet tjetër brenda Universitetit të Tetovës ose brenda institucioneve të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Kriteret e transferimit përcaktohen nga universitetet në varësi të përputhshmërisë së programeve të tyre të studimit.

Studenti i Universitetit, gjegjësisht i njësisë, mund të kryejë një pjesë të programit të studimit në një institucion tjetër të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit (në tekstin e mëtejme: student i institucionit amë/student vendas) për një kohëzgjatje prej një semestri dhe maksimumi dy semestra, gjegjësisht një vit akademik.

Studenti nga një institucion tjetër i arsimit të lartë nga vendi ose nga jashtë mund të kryejë një pjesë të programit të studimit në Universitet, gjegjësisht në njësi (në tekstin e mëtejme: student - mysafir) në kohëzgjatje të një semestri dhe maksimumi dy semestra, gjegjësisht një vit akademik, të mbështetur në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet universiteteve për njohjen reciproke të ECTS kredive të dhëna/fituara. Studenti mysafir ka statusin e studentit të rregullt ose me korrespondencë dhe ka të njëjtat të drejta dhe detyrime të studentëve të përcaktuara me këtë rregullore, rregulloret për ciklin e parë, të dytë gjegjësisht të tretë të studimeve. Të drejtat e tij, shpenzimet e studimit dhe çështje të tjera që lidhen me statusin e tij rregullohen me marrëveshje.

Neni 41

Studenti vendas, përkatësisht student mysafir nga neni 41 i kësaj rregulloreje, pas përfundimit të pjesës së programit të studimit në një institucion tjetër të arsimit të lartë, i vazhdon studimet në institucionin e tij amë dhe i transferon ECTS kreditë/pikët e fituara që i njihen në përputhje me marrëveshjen për njohjen reciproke të ECTS kredive/pikëve të lidhur ndërmjet universiteteve, gjegjësisht njësive dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Kriteri bazë për njohjen e ECTS kredive është rezultati i procesit mësimor i përcaktuar nga programi i studimit.

Vendimin për njohjen e ECTS kredive, vendimin për kalimin nga një universitet tjetër/nga një njësi në tjetrën/nga një drejtim në tjetrin brenda njësisë/njësive dhe njohja e provimeve që student i ka dhënë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, i miraton Universiteti, të përgatitura nga koordinatori për ECTS i Universitetit në bazë të procesverbalit të prodekanit të njësisë.

Neni 42

Marrëveshja nga neni 41 i kësaj Rregulloreje rregullon të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të institucioneve të arsimit të lartë në drejtim të sigurimit të kushteve të studimit për studentët - mysafirë në vendin pritës, si: shpenzimet e akomodimit, ushqimit, transportit, kujdesit shëndetësor dhe shpenzimet tjera që ka student mysafir gjatë qëndrimit të tij në vendin pritës.

Marrëveshja e bashkëpunimit nënshkruhet nga rektori i Universitetit dhe personi i autorizuar i institucionit tjetër të arsimit të lartë.

Transferimi i studentëve nga një njësi në tjetrën në Universitetin e Tetovës

Neni 43

- (1) Të gjithë studentët kanë të drejtë të transferojnë studimet, brenda njësive akademike ekzistuese të Universitetit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
- (2) Transferimi bëhet vetëm në programet aktive të studimit.
- (3) Pas realizimit të transferit ECTS, studenti, gjatë regjistrimit në programin që transferohet, ka detyrim të çregjistrohet nga programi nga i cili transferohet, sipas natyrës së programit të studimit dhe mënyrës së studimit.
- (4) Të drejtën e transferimit brenda njësive të Universitetit mund ta ushtrojnë studentët dhe kandidatët që kanë përfunduar së paku një semestër.
- (5) Transferimi i ECTS kredive mund të realizohet edhe në kuadër të drejtimeve të të njëjtit program studimi ashtu edhe ndërmjet planeve dhe programeve të ndryshme të të njëjtit program studimi. Dallimet në mes të lëndëve përcaktohen nga koordinatori për ECTS në fakultet dhe komisioni.

Transferimi i studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë

Neni 44

- (1) Nga institucionet tjera të arsimit të lartë në vend dhe jashtë vendit, në njësitë e universitetit, të drejtë transferimi kanë të gjithë kandidatët që janë regjistruar ose kanë përfunduar të paktën një semestër në një universitet tjetër, ndërsa obligimet tjera do t'i realizojnë konform statusit të transferimit në programin përkatës të studimit.
- (2) Gjatë aplikimit duhet të dorëzohet dëshmia e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë, përkatësisht fakultetit ose programit nga i cili është bërë transferimi. Komisioni i transferimit mund të kërkojë edhe dokumente shtesë që janë të nevojshme për realizimin e transferimit në përputhje me ligjin, Statutin e Universitetit dhe këtë rregullore.
- (3) Gjatë aplikimit gjithashtu dorëzohet edhe ekuivalentimi i notave nga Ministria përkatëse e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së.
- (4) Studenti mund të transferohet në një nga fakultetet ekzistuese dhe në program ose drejtim të njëjtë ose të ngjashëm me fakultetet dhe programet e studimit të Universitetit. Ngjashmëria përcaktohet nga komisioni i transferimit në kuadër të fakultetit.

(5) Kandidatët të cilët do të kryejnë transfer, regjistrohen si studentë me statusin e studimit - bashkëfinancim, gjegjësisht sipas tarifave aktuale për programet e studimit në vitin aktual akademik.

(6) Në programet e studimit, në të cilat sipas konkursit për regjistrimin e studentëve ka provim pranues, kandidatët që aplikojnë për transferimin e kredive janë të obliguar të japin provim pranues për lëndët e veçanta.

Koordinimi, realizimi dhe zbatimi efikas i ECTS

Neni 45

Sektori për veprimtari mësimore-arsimore i monitoron dhe i evidenton aspektet administrative dhe akademike të ECTS-ve në nivel universitar dhe realizon bashkëpunim aktiv me studentët.

Në njësité e Universitetit ka koordinatorë dhe/ose kuadër administrativ profesional për ECTS.

Neni 46

Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshilltarit për ECTS përcaktohen me akt për sistemimin e vendeve të punës në Universitet.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve dhe/ose kuadrit administrativ profesional për ECTS përcaktohen me akt të veçantë të njësive të Universitetit.

PAKETA E INFORMACIONEVE/UDHËZUES PËR STUDIME DHE BASHKËPUNIM

Neni 47

Për të informuar studentët e interesuar për mundësitë dhe kushtet e studimit në Universitet, në faqen zyrtare të tij, Universiteti publikon një paketë informacionesh/informator (Information Package).

Pakoja e informacioneve/informatori publikohet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe atë angleze.

Neni 48

Universiteti dhe njësité, për të siguruar qasje në publik, transparencë dhe efikasitet në informimin e përdoruesve ekzistues dhe të ardhshëm të shërbimeve arsimore, janë të detyruar

të përgatisin dhe shpërndajnë paketat e informacionit në formë të shkruar përmes botimeve, manualeve, udhëzuesve etj. dhe në formë elektronike përmes CD-ve, internetit, faqeve të internetit etj.

Për ta realizuar informimin e plotë, Universiteti ofron mbështetje adekuate harduerike dhe softuerike.

Neni 49

Njësia e Universitetit duhet të përgatisë një paketë të informacioneve për ECTS, e cila është udhëzues për studim dhe bashkëpunim.

Në bazë të paketave informuese të njësive nga paragrafi paraprak, Universiteti përgatit një paketë të vetme të informacioneve për ECTS.

Neni 50

Paketa e informacioneve duhet të përmbajë këto elemente:

- përshkrimin e ofertës arsimore të njësisë së Universitetit (lëndët, kurset, drejtimet, etj.),
- përshkrimin e sistemit për vlerësimin dhe dhënien e provimeve dhe
- përshkrimin e sistemit të kredive dhe të kushteve për avancim.

Përmbajtja e pakos së informacioneve është dhënë në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 51

Njësitë e Universitetit janë të detyruara, për të siguruar qasje për publikun dhe efikasitet në informimin e përdoruesve ekzistues dhe atyre të ardhshëm të shërbimeve arsimore, të krijojnë paketa të informacioneve dhe t'i shpërndajnë ato në formë të shkruar (publikime, manuale, udhëzues, etj.) dhe /ose në formë elektronike (CD, faqe interneti, etj.).

Universiteti dhe njësitë e Universitetit, për të arritur informimin e plotë, ofrojnë mbështetje adekuate harduerike dhe softuerike.

Neni 52

Pakoja e informacioneve përgatitet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe atë angleze. Paketa e informacioneve mund të përgatitet edhe në gjuhë tjera, përveç gjuhëve nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Përmbajtja e paketës së informacioneve është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 54

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Neni 55

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për sistemin e vetëm kredive dhe kalimin nga një program studimi në tjetrin, gjegjësisht nga një institucion në një tjetër të arsimit të lartë, nr. 02-1068/1 e datës 24.2.2009.

 **Kryetari,**
Prof. Dr. Vullnet Ameti